


REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR TIRANË

Nr.3012/334 Akti

Datë 21.12.2020 Regj.Them.

Datë 15.02.2021 Vendimi

VENDIM

"NË EMËR TË REPUBLIKËS"

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

GJYQTAR: ARTAN GJERMËNI

Me pjesmarrjen e sekretares gjyqësore **Ornela BALLA** në Tiranë, sot më datë **15.02.2021**, pasi mori në shqyrtimin në seancë gjyqësore me dyer të mbyllura, çështjen penale me **Nr. 3012/334 Akti**, me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga prokurori **Sokol Malaj**.

OBJEKTI:

- Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal **Nr.524 viti 2019**, në ngarkim të të pandehurit **Maurizio Lombi (Luan Shehu)**-i biri i Ahmet dhe i Lihe,i datë;indjes 19.05.1966,lindur ne Kukes dhe banues në Tiranë,me arsim të mesëm,beqar,me shtetesi dhe kombësi shqiptare,në mungesë,përfaqësuar nga avokate **Olta Myftaraj** me Nr. 7567 License dhe NIPT L42104009A,Anetare e Dhomes se Avokatise Tirane,i akuzuar për kryerjen e veprës penale **"Mashtrimi"**, të parashikuar nga neni 143/3 të Kodit Penal .
- Pushimin e çështjes penale për veprën penale **"Mashtrimi"** të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal .

BAZA LIGJORE : Neni 328/1/b,329/a dhe 331 të K.Pr.Penale.

VIKTIMA: **Emror Kasaj**-i biri i Haxhi dhe i Xhevahire,i datëlindjes 18.04.1976,lindur ne Permet dhe banues në Tiranë,me adresë:Lagjia 6,Rruga "Tre Deshmoret",banese private pa numer,me arsim te larte,i martuar,i padënuar më parë,me shtetësi dhe kombësi shqiptare,jo-prezent.

KALLËZUESI:**Dashor Alicka**-i biri i Selman dhe i Shpreses ,i datëlindjes 15.11.1969,lindur ne Erseke dhe banues në Tiranë,i martuar,me arsim 8-klasë,i padënuar më parë,me shtetësi dhe kombësi shqiptare,jo-prezent.

Në përfundim të gjykimit,zhvilluar në prani të përfaqësuesit të prokurorisë, si dhe avokates,Gjykata pasi shqyrtoi në tërësi rrethanat e çështjes dhe çmoi dhe vlerësoi në

tërësi provat e marra në seancë gjyqësore ,nënshtruar rregullave të gjykimit të seancës paraprake dhe dëgjoi në fazën e konkluzioneve përfundimtare palët, në të cilën u kërkuar:

Prokurori: Pranimin e kërkesave.

Avokati dhe i pandehuri: Kthimin e cështjes për hetim ose pushimin e saj.

VËREN

Se, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë janë paraqitur kërkesat me objekt:

- Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal **Nr.524 viti 2019**, në ngarkim të të pandehurit **Maurizio Lombi (Luan Shehu)**,i akuzuar për kryerjen e veprës penale **“Mashtrimi”**, të parashikuar nga neni 143/3 të Kodit Penal .
- Pushimin e cështjes penale për veprën penale **“Mashtrimi”** të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal .

Gjykata në çështjen objekt gjykimi ,vendosi të njoftojë palët për datën dhe orën e seancës paraprake të paktën 10 ditë përpara zhvillimit të saj, në mënyrë që t’u japë mundësinë të njihen me të gjitha aktet e hetimit paraprak dhe të përgatisin pretendimet e tyre.

- **Rrethanat e faktit penal, burimet e provës:**

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar ceshtjen penale nr.524, të vitit 2019, për veprën penale "Mashtrimi me pasoja të rënda", të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

Gjithashtu më datë 21.10. 2019 mbi bazën e kallezimit penal të shtetasit Dashor Alicka është regjistruar cështja penale nr.7981 për veprën penale të parashikuar nga neni 143 I K. penal.

Këto cështje penale me vendimin datë 15.11 2019 janë bashkuar në një te vetme me numer 524 te vitit 2019.

Nga studimi i kallezimit penal të shtetasit Emeror Kasaj dhe akteve bashkelidhur ka rezultuar si më poshte;Deri në mesin e vitit 2010 ai ka jetuar së bashku me prindërit ne lagjen Yzberisht - Tirane, pranë fabrikës se tullave silikate. Rreth fund vitit 2009 eshte vene ne dijeni se fqinji tij shtetasi Haredin Alicka ishte duke shitur nje sipërfaqe toke prej 1000 m2 toke are se bashku me nje ndërtesë ne proces legalizimi, te ndërtuar mbi kete sipërfaqe toke. Duke qene se e kishte fqinj ai ka mare përsipër ti gjente nje blerës.

Per sa më siper ai ka komunikuar me një shtetas që quhet Agim Neziri, në emailin e tij “Tony Neziri <a2elondon@yahoo.com>, i cili prej vitesh jeton familjarisht ne Londer. Ky është burri i kushërirës se pare te bashkëshortes se tij dhe per kete arsye ka njohje me te. Këtij shtetasi i ka çuar e-mail ne daten 17 Mars 2010 nga emaili i tij me adrese emrorkasaj@yahoo.com ku i ka sqaruar situatën dhe leverdinë per ta blerë kete sipërfaqe toke me qellim dhënien e saj per ndërtim meqë ishte ne pozicion te mire ne fushën ”Misto Mame” dhe nderkohe kishte kontaktuar dhe me nje ndertues te interesuar (shoqerine

TREMA ENGINEERING 2 sh.p.k. me Administrator z. Ilir Trebicka. Agimi, pasi kishte lexuar e-mailin i ka kthyer pergjigje se do i dërgonte nje te njohurin e tij nga Kukesi, edhe ai me banim ne Londer, i quajtur Maurizio Lombi (Luan Shehu). Ne telefon i ka sqaruar se nuk kishte mundësi financiare te tilla vete prandaj do te dergonte Luanin te cilin kallezuesi e njihte me pare per shkak te mardhenieve te punes pasi kishte qene kallezues ne nje ceshtje penale .

Ai është takuar me të pandehurin Maurizio Lombi dhe i ka sqaruar se ku ishte prona, duke e prezantuar edhe me shitësin. Pasi e pa pronën atij i pëlqeu dhe meqë nuk donte te investonte vete gjithë shumen, duke qene me dyshime se nëse mund te dilte leje ndërtimi ne ate vend, kërkoi qe ta blinte gjysem per gjysem me mua ate prone.

Kështu përfundimisht ata e kane blere kete prone bashke me kontratën noteriale te perpiluar tek notere Elmira Kodra, me zyre ne rrugën e Durrësit. Duke qene se kishin disa muaj qe njiheshim dhe ishin bashkepronare , ky i fundit, ne fund te muajit Dhjetor 2010 i ka qare hallin per nje problem financiar te ngutshëm sipas te cilit i duheshin urgjent nje shume prej 50 000 euro vetëm per nje jave pasi kishte ne dore nje shitblerje prone me te cilën do te fitonte shume, por qe nuk i kishte te gjitha parate. Ai i ka kërkuar ndihme qe ti gjente këto para nga miq te tij sepse ai e dinte qe kallezuesi nuk kisha mundësi financiare. Shtetasi Emeror Kasaj nisur nga fakti qe ishin bashkepronare dhe duke qene i sigurt qe ai kishte shume prona dhe duke e besuar ne mundësitë financiare shume te mëdha qe kishte dhe qe i tregonte sa here takoheshin , i ka premtuar qe do ti gjente shumen qe ai kërkonte dhe do ja jepte per nje jave.

Në keto kushte ai ka mare te nje miku i tij shumen 50 000 euro, e gjitha ne prerje 500 euro dhe ne javën e fundit te dhjetorit 2010 te gjithë tufën e parave prej 100 prerje te tilla ja ka dhene ne dore përpara prokurorisë Tirane, perballe hyrjes se zyrës se ekspertit Valentin Haxhiraj.

I pandehuri Maurizio Lombi i ka premtuar se parate do ja kthente brenda javes pasi kishte per te marre nga pronari i lokal "TAIËAN" shtetasi Besnik Sulaj nje shume te konsiderueshme parash pasi kishte kohe qe i linte me përqindje 5% ne muaj këtij shtetasi shume te mëdha. Ne momentin qe i ka dhene huane e sipërcituar, ai i kishte thene se i kishte dhene Besos nje shume prej rreth 600 000 euro me 5% ne muaj. Ditet e para pas kesaj shtate ata jane takuar me Maurizion dhe vellain e tij Sulejmanin te zyra e nje permbaruesi dhe aty ka ardhur ne dijeni qe shtetasi Besnik Sulaj kishte probleme financiare pasi kishte shume kredi per te paguar.

Kur dolën nga lokali shtetasi Emeror Kasaj ka biseduar me te pandehurin Maurizio Lombi duke i thene qe ky fakt ishte problem shume i madh prandaj te paktën duhet te shkonin te noteri te nënshkruante deklaratën qe i kishte marre 50 000 euro borxh. I pandehuri Maurizio Lombi nisur nga mosbesimi i kallezuesit dhe mardhenia e tyre e meparshme eshte indinjuar dhe per momentin ata nuk e hartuan deklaraten noteriale.

Pas këtij momenti kaloj nje periudhe disa mujore por i pandehuri Maurizio Lombi e mashtronte vazhdimisht. Nje periudhe ai i ka premtuar kallezuesit se do shiste nje lokal

tek nje pallat i ri shume katesh ne rrugën “Myslym Shyri” ngjitur me shkollen “ Arben Broci”. Aty kishte nje apartament ne katet e sipërme dhe nje lokal ne katin e pare fiks nga krahun i kundërt i shkollës. Ai e ka shitur lokalin (per apartamentin nuk ka dijeni) dhe përsëri nuk i ka dhene as paratë as nuk nënshkroi ndonjë kontrate tek noteri. Mardhenia mes tyre u be me e veshtire edhe per faktin se personi prej te cilit blene pronen dhe ja lane ne huapërdorje per pak muaj, ne përfundim te kontratës se huapërdorjes, jo vetëm nuk e liroi pronën por i ka hedhur ne gjyq per pavlefshmëri kontrate, me qellim per te prishur kontratën me ta pasi kishte gjetur nje blerës qe i ofronte me shume para. Ne lidhje me kete shitës te pronës, per nje periudhe disa vjeçare ata kane qene ne procese gjyqesore dhe te gjitha shpenzimet gjyqesore jane paguar nga shtetasi Emeror Kasaj. I pandehuri Murizio Lombi i ka premtuar se keto shpenzime se do ja jepte te gjitha njëherësh, bashkë me borxhin. Vetem nga shpenzimet gjyqesore shumëvjeçare deri tani kur ceshtja gjyqesore eshte ne Gjykatën e Larte, I pandehuri Maurizio Lombi i detyrohet 10 000 euro qe i ka paguar kallezuesi nga pjesa e tij e detyrimeve.

Situata u vështirësua shume kur i pandehuri Maurizio Lombi mashtroi hapur edhe vëllain e tij Suljemanin , pasi atij i duheshin rreth 75 000 euro per punët e tij dhe per tja mare vëllait te tij Sulejmanit, i premtoi se do ti shiste gjysmën e pjesës se vet nga prona qe kishin blere bashke ne fushën Misto Mame. Keshtu pasi mori paratë prej vëllait te tij, Sulejmani i kërkoi si nder qe te bente deklarate noteriale sipas te cilës hiqja dore nga e drejta e parablerjes si bashkëpronar per pjesën qe do te shiste Luani, me qellim qe ta blinte Sulejmani, i cili mesa dinte ja kishte parapaguar çmimin. Keshtu, bazuar ne nenin 204 te K.Civil per te drejtën e parablerjes, ai, Sulejmani dhe Luani kane shkuar tek zyra e noterit Robert Koli ne bulevardin Zogu i Pare, ku kishin folur paraprakisht Luani dhe Sulejmani, pasi ishte çështje e tyre.

Sekretarja e noterit, ka hartuar deklaratën me qellim qe ai dhe Luani ta nënshkruanin. Por, pasi kallezuesi e ka nënshkruar, Luani nuk pranoi ta nënshkruante duke pretenduar se do ta studionte fillimisht ne shtëpi pastaj do vinte per ta firmosur. Kur kane dale nga zyra e noterit, ai ka pyetur Luanin ishte vetëm se perse nuk e nënshkroi aty per aty deklaratën. Ai i ka thene “nuk u çmenda ti shes pjese Sules (Sulejmanit, te cilit ja kishte mare nderkohe paratë), pasi Sula ben komande edhe kur nuk eshte bashkëpronar dhe jo po te kishte pjese ne prone”. Pra sipas tij ai do te mbaronte pune me paratë e vëllait te tij dhe do tja kthente përsëri. Ne këto rrethana, ne prani te Sulejmanit, duke ecur rrugës nga zyra e noterit deri tek lokal “Caplin” ne qendër te Tiranës kallezuesi i ka kerkuar te lëshonte te paktën deklaratën noteriale qe i kishte mare paratë borxh.

I pandehuri Maurizio Lombi e ka anashkaluar kete teme duke ju justifikuar me lloj lloj gjerash dhe konkretisht qe e kisha prezantuar me blerësin e pronës i cili nuk ua liroi pronën e shitur por i kishte hedhur ne gjyq per pavlefshmëri kontrate dhe kthim te palëve ne gjendjen e mëparshme. Nderkohe, kishte mbaruar gjykimi ne shkallen e pare dhe ceshtja ishte ne Apel. Ne debat e sipër, vëllai i tij Sulejmani qe ishte ne dijeni te faktit qe I pandehuri Maurizio Lombi i kishte marre 50 000 euro, i thoshte; “Po ktheja leket o Luan”, por ai vazhdonte me te tijen duke e mashtruar dhe duke u sjelle si viktime, vetëm qe te mos i nënshkruante nje deklarate noteriale. Pas shume debatesh me te bërtitura, me ne fund i pandehuri Maurizio Lombi premtoi, si shume here te tjera, se do e

nënshkruante deklaratën dhe do i kthene borxhin sapo ceshtja te përfundonte ne Gjykatën e Apelit. Ceshtja civile përfundoi ne gjykatën e apelit përpara pese vjetësh dhe qe atëherë ai akoma nuk i ka leshur deklaratën dhe as me ka dhen paratë. Shtetasi Emeror Kasaj i ka kërkuar me ngulm pas kësaj date qe te i jepte paratë dhe ka disa vjet qe ndryshoi strategji duke i thene se nuk do i kthente borxhin, por meqë e paskështa mare ne qafe qe i kisha prezantuar shitësin Haredin Alicka, do i shiste pjesën qe kishte blerë vete, duke kërkuar përveç shumes 50 000 euro qe i kishte marre, edhe nje shume prej 100 000 euro te tjera qe te plotësohej çmimi prej 150 000 euro qe kishte blere pronën.

Pra sipas tij, ai do i vinte si kusht qe te blinte pronën e tij megjithëse ceshtja ishte në gjykatë dhe po te humbisnin gjyqin (gjyq qe aktualisht eshte ne gjykatën e larte dhe nuk ka përfunduar) te gjithë koston do ta paguante kallezuesi sepse ai do te merrte paratë qe kishte paguar dhe do dilte pa asnjë humbje. Duke qene i detyruar dhe per te mos humbur paratë qe i kishte dhene, kallezuesi ka kerkuar per shume kohe blerës te pronës se tij me qellim qe vjehrra e tij prej te cilës ka mare paratë nga banka ne datën 23.04.2014 dhe likuidoi mikun e tij biznesmen qe ja kishte dhene borxh katër vjet me pare, te behej bashkepronare ne 1/3 e pjesës se qe Luani do te shiste dhe 2/3 ti blinte nje person tjetër qe po kërkonte te dilte si bleres. Keshtu, pas shume përpjekjesh, kallezuesi ra dakord qe 50 000 euro te tjera ti investonte bashkeshorti i tezes se tij qe banon prej shume vitesh ne Angli familjarisht, me paratë qe kishte mbledhur per te blere banesën sociale ne te cilën shteti anglez e kishte futur me qera. Pjesen tjetër prej 50 000 euro do ta investonte motra e shtetasit Emeror Kasaj me banim prej 15 vjetesh ne SHBA e cila ka qene ne tratativa (dhe eshte akoma ne tratative) per te blere nje banesë ne Shqipëri.

Per te realizuar kete mardhenie motra e tij ka ardhur nga SHBA dhe pasi është bere te notere Djana Kamberi nje prokure ku e autorizonte kallezuesin te nënshkruante nëse nuk do përfundohej marrëveshja gjate kohës se shkurtër qe ajo do te qëndronte ne Shqiperi, ka dorëzuar ne llogarinë e noteres Djana Kamberi ne bankën Raifaisen, ne rrugën e Duresit, shumen 50 000 euro te cilën e ka konvertuar ne leke shqiptare pasi llogaria e noteres ishte ne leke. Njekohesisht ai ka mare parate ne shumen 50000 euro por ne shume te ekuivalentuar ne paund britanik nga burri i teses shtetasi Njazi Xheza i ka mbajtur rreth nje muaj ne kasafortën e kolegut Genti Plaku me te cilin punonte ne zyre. Pasi u hartua kontrata, I pandehuri Maurizio Lombi njësoj si tek noteri Robert Koli, nuk e nënshkroi kontratën e te merrte menjëherë te gjithë shumen e parave te kërkuar, por mori nje kopje dhe tha se do ta studionte nje here ne shtëpi duke premtuar se do te vinte nje dite pas ta firmoste. I pandehuri Maurizio Lombi nuk e firmosi kontraten dhe shtetasi Njazi Xheka, erdhi dhe morri paratë e tij qe i kishte dhene kallezuesit ndërsa paratë e motrës se tij Matilda Ellis jane ende ne llogarinë e noteres Djana Kamberi.

Ne muajin nëntor 2015 shtetasi Emeror Kasaj eshte emëruar prokuror ne prokurorine e rrethit Gjyqesor Gjirokaster . Ne kete periudhe e ka marre ne telefon ne nje nate mbrëmje nga Gjirokastra dhe pasi e ka përshëndetur, i ka kërkuar me sms qe te leshoje deklaratën noteriale pasi kete fakt e kishte deklaruar edhe per nevoja te procesit te veting-ut dhe se i prishte pune nëse nuk e lëshonte deklaratën.

Po kështu, përpara disa viteve i pandehuri Maurizio Lombi i premtoi se kishte një banesë në katin e katërt ose të pestë të një kompleksi pallatesh që ndërtonte Bashkim Ulaj tek Burgu nr. 313 dritarja e të cilit shikonte nga oborri i burgut dhe pallati ishte në kufi me anën perendimore të burgut. Ai ka thënë se tha se donte edhe 30 000 euro të tjera dhe tja shiste vjehrrës së kallezuesit për shumën totale 80 000 euro meqë 50 000 i kishte marrë borxh tek ai. Kështu bashkë me bashkëshorten dhe vjerrën kanë shkuar dhe kanë parë apartamentin që i kishte sugjeruar Maurizio. Ata kanë vënë re që dera e banjës ishte nga korridori dhe donin ta kthenin nga dhoma e gjumit. Për këtë kanë shkuar të zyrat e shoqërisë ndërtuese "Gener 2" por punonjësja e shoqërisë u tha se nuk bënte asnjë spostim muri pa miratimin e personit që ishte në kontratë zyrtarisht, pra, i pandehuri Maurizio Lombi. Kallezuesi i ka kërkuar atij të autorizonte një gjë të tillë por ai u shmang dhe nuk e bëri kurrë. Përpara rreth një muaji e gjysëm, në datën 02.11.2018, rreth orës 12.00, kallezuesi e ka parë rastësisht përpara komisarariatit të policisë nr. 3 Tiranë dhe pasi u takuan sepse u gjendëm përballë kur doli nga dera e komisarariatit, e ftoi të pinin një kafe tek lokali përballë komisarariatit dhe të bisedonin.

Në bisedën e zhvilluar i pandehuri Maurizio Lombi i premtoi që javën tjetër do i lëshonte deklaratën të noteri. Ai i ka thënë i ka thënë se do rrinte në Tiranë për tre muaj. Kur është kthyer në fund të javës nga Gjirokastra kallezuesi e ka marrë në telefon në datën 10 Nëntor 2018 dhe i ka shkruar në SMS në Viber duke e pyetur ku ishte, me qëllim që të shkonin të noteri, sic e kishin lënë. I pandehuri Maurizio Lombi i ka shkruar se ishte në Londër. Kallezuesi i ka shkruar që duhet të vinte të nënshkruante deklaratën ndërsa ai i ka kthyer përgjigje me sms se nuk i kishte asnjë borxh.

Në funksion të hetimeve kallezuesi Emeror Kasaj ka paraqitur të printuara edhe disa komunikime nëpërmjet sms që ka patur me të pandehurin Maurizio Lombi. Është bërë kështu e telefonit të tij në lidhje me komunikimet që ai ka patur edhe nëpërmjet aplikacioneve viber në rubrikën Chats, ku ka rezultuar se bisedimet midis këtyre shtetasve zhvillohen për detyrimet e paleve si dhe për mardhënien midis tyre. Gjithashtu është bërë edhe kështu e emailit të kallezuesit të disa komunikimeve në lidhje me rrethanat e hetimit, ku ka rezultuar se Emeror Kasaj në vitin 2010 i ka dërguar e-mail një të njohuri të tij me emrin Gimi (Agim Neziri) i cili banon në shtetin Anglez, ku e informon për mundësinë e blerjes së tokës, ky i fundit i ka kthyer përgjigje duke e vënë në dijeni se do të komunikonte me shokun e tij i cili quhej Luan, pasi ai kishte dëshirë për të investuar në Shqipëri. Në këtë adresë emaili gjendet një folder i cili mban datë 21.07.2014, brenda të cilit ndodhet e formuluar një «Kontratë Huaje» në të cilën i pandehuri Maurizio Lombi është në rolin e huamarresit dhe Emeror Kasaj në rolin e huadhenesit.

Është administruar me procesverbal nga ana e kallezuesit kopje e formularit në lidhje me deklaratën e pasurisë si subjekt rivlerësimi që mbart detyrimet për deklarimin e pasurisë, si dhe kopje e prokurës së posacme datë 24.02.2014 ku shtetasja Matilda Ellis emeron përfaqësues të saj kallezuesin Emeror Kasaj për kryerjen e veprimeve të nevojshme për blerjen dhe regjistrimin e pasurisë të pasqyruar në kontratë.

Është bërë kqyrja dhe transkriptimi i bisedave të regjistruara nga ana e kallëzuesit nëpërmjet aparatit të tij telefonik si dhe është bërë sekuestrimi i aparatit telefonik të tij si burim i provës e është dërguar për ekspertim elektronik për të verifikuar autenticitetin e këtyre regjistrimeve të bërë nga aparati celularë. Jane transkriptuar bisedat e regjistruara me aparatit telefonik të mesiperm, ku nga keto biseda rezulton se shtetasi Emeror Kasaj diskuton me të pandehurin Maurizio Lombi për një detyrim në vlerën 50.000 Euro. Nga kjo bisedë në teresi vlen të theksohet se i pandehuri Maurizio Lombi, nuk shprehet në lidhje me detyrimin e pretenduar nga kallzuesi Emeror Kasaj prej 50.000 Euro, por kur i kërkohej nga kallzuesi që të shkojë për të nënshkruar një deklaratë noteriale për njohje detyrimi, i pandehuri Maurizio Lombi shprehet se do ta kontaktojë. Kallzuesi i thotë të shkojë tek noteri të nesërmen mbas ditës që zhvillohet biseda, ndërsa i pandehuri Maurizio Lombi i pergjigjet se nuk ka mundësi të nesërmen, por do ta vendosë ai. Ky fakt provon që i pandehuri Maurizio Lombi pranon marrjen e kësaj shume parash por nuk dëshiron që të formalizojë këtë detyrim me një deklaratë noteriale.

Nga pergjigja e ardhur me aktin e ekspertimit me nr.3127, datë 24.04.2020 dërguar nga Instituti i Policisë Shkencore, ka rezultuar se «Skedari regjistrim audio me emertimin «Rregjistrimi i mashtresit të kom. Pol. 3.m4a» është regjistruar nga telefoni celular objekt ekspertimi me datë 02.11.2019, në intervalin kohor nga ora 11:27:47- 11:40:43.

Në funksion të hetimeve i është kërkuar informacion bankave të nivelit të dytë në lidhje me llogaritë dhe lëvizjet në llogari të kryera nga ana e të pandehurit Maurizio Lombi (Luan Shehu) për periudhën 2010 – 2018. Nga pergjigjet e ardhura nga bankat e nivelit të dytë rezultoi se i pandehuri Maurizio Lombi për periudhën e kërkuar ka kryer shume transaksione në banka të ndryshme. Keto transaksione kanë vlera të konsiderueshme, të cilat e kalojnë shum herë vlerën e pretenduar nga kallzuesi që i ka dhënë të pandehurit Maurizio Lombi.

Në bazë të kërkesës tone, ZQRPP ka vënë në dispozicion dokumentacionin mbi pasuritë e regjistruara në emër të të pandehurit Maurizio Lombi, ku ka rezultuar se në emrin e tij janë të regjistruara shume pasuri, kryesisht apartamente, njësi shtëmbimi dhe garazhe. Nga aktet rezultoi se ky shtetas kryen shitblerje apartamentesh në vlera të konsiderueshme. Jane dërguar shkresa Zyrës Qëndrore të Interpolit si dhe Drejtorisë së Policisë së Shtetit nëse në ngarkim të të pandehurit ka të dhëna për veprimtari antiligjore etj. Nga kthim pergjigjet ka rezultuar se i pandehuri Maurizio Lombi ose (Luan Ahmet Shehu), nuk është person me precedent penal në Shqipëri apo jashtë saj.

Janë marrë të dhëna nga shoqëria ndërtuese «Gener 2» në lidhje me një marrëdhënie kontratë porosisë që ky shtetas ka patur me shoqërinë në fjalë për blerjen e një apartamenti të cilin në vijim e ka tjetërsuar sipas një akt marrëveshje për kalim të drejtash e kontratë shitblerje. Për këtë apartament i kallzuari ia ka kaluar të drejtat e pronësive shtetasit Fran Jaku nëpërmjet «Akt Marrëveshjes me nr.3729 Rep dhe me Nr.957 Kol., datë 21.07.2014, me vlerë shitje 80.000 Euro. Nga ky fakt del qartë që i pandehuri Maurizio Lombi vazhdimisht e ka mashtruar kallzuesin duke i ofruar mundësi të ndryshme për të shlyer shumën e marrë dhe indirekt del qartë që ai e ka marrë këtë shume.

Gjithashtu informacion është marrë edhe nga drejtoria e përgjithshme e sigurimeve shoqërore, Ministria e Drejtësisë, QKB, ALUIZNI etj. Duke administruar përgjigjet dhe të dhënat e mbledhura në funksion të hetimeve. Ku ka rezultuar se ne emer te te pandehurit Maurizion Lombi figurojne shume veprime noteriale te kryera gjate periudhes 2013-2018. Sipas kthim pergjigjes se QKB, ne emer te shtetasit Maurizio Lombi ose Luan Ahmet Shehu, figurojne te regjistruar shume aktivitete ne fusha te ndryshme nga viti 1995 e ne vijim.

Nëpërmjet procesverbalit të kqyrje marrjes së dokumentave datë 18.07.2019 jane administruar Prokura e Posaçme leshuar ne 23.02.2014 nga shtetasi Njazi Xheza, ku emeron perfaqesues te tij shtetasin Emror Kasaj per te nenshkruar kontraten e shitblerjes se pasurise Nr.380/5, vol.9, fq.189, Zk.3866 me siperfaqe 1.000 m2, si dhe «Prokura e posaçme» date 24.04.2014, leshuar nga shtetasja Matilda Ellis, me objekt nenshkruar kontraten e shitblerjes se pasurise Nr.380/5, vol.9, fq.189, Zk.3866 me siperfaqe 1.000 m2, si dhe nje draft kontrate pergatitur nga noterja Diana Kamberi.

Eshtë marrë deklaram shtetases Diana Kamberi e cila ushtron funksionin e noteres publike. Kjo shtetase shpjegon se ka perpiluar dy prokura te posacme me kerkese te shtetasve Njazi Xheza dhe Matilda Ellis, ku caktojne perfaqesues te tyre shtetasin Emror Kasaj, per blerjen e pasurise se sipercituar. Këto shtetas kanë derdhur në llogarine e noteres shuma parash te cilat do te sherbenin per kryerjen e transaksionit. Deklaruesja shpjegon se shtetasi Emror Kasaj eshte paraqitur ne zyren e noteres sebashku me nje shtetas tjeter, i cili i eshte prezantuar si pale ne kontrate dhe i kane kerkuar perpilimin e nje draft kontrate per kalimin e te drejtave te pronesise. Pas hartimit te draft kontrates shtetasja Diana Kamberi i ka dhene nga nje kopje paleve te cilet ta konsultonin dhe me pas te vendosnin. Pala shitesse i ka thene noteres se do ta konsultonte dhe me pas do te paraqitej per ta nenshkruar, por nje gje e till nuk ka ndodhur. Keto prokura jane administruar duke marre kopje te tyre, si dhe eshte marre kopje e draft kontrates midis paleve te mesiperme, por qe nuk eshte nenshkruar nga palet.

Në funksion te hetimit eshte marre deklaram shtetases Luiza Petraj e cila sqaron se vajza e saj eshte bashkeshortja e shtetasit Emror Kasaj. Gjatë bisedave familjare ka marre vesh se dhendri i saj, kishte nje problem me nje ortak te tij, pasi i i kishte dhene nje shume parashe prej 50.000 Euro me nje afat shlyerje nje jave, por ky shtetas qe ishte me origjine nga Kukes i nuk ia kishte kthyer ende. Ne keto kushte shtetasja Luiza Petraj deklarone se i ka kaluar në llogarine e vajzës së saj Esmeralda Kasaj shumën e parave prej rreth 90.000.000 leke dhe kane rene dakort qe ne momentin qe dhendri i saj do te merrte parate qe i detyroheshin, do shlyente shtetasen Luiza Petraj. Deklaruesja shton se dhendri i saj Emror Kasaj i ka propozuar per te blere nje apartament prane burgut 313 te cilin e kishte shtetasi Luan dhe e shiste ne vleren 80.000 Euro. Duke qene se ai nuk po i shlyente detyrimin dhëndrit prej 50.000 Euro, i kishte propozuar qe dhendri i saj Emror Kasaj ti jepte dhe shumen prej 30.000 Euro dhe me pas do te ishin te lare. Pasi pane apartamentin kane kerkuar nga shoqeria ndertuese disa ndryshime te brendshme, por shoqeria Gener 2, i ka thene se nuk mund te bente ndryshime pa nenshkruar një kontrate shitje me pare.

Nga sa me sipër organi i akuzës ka konkluduar se i pandehuri Maurizio Lombi ka kryer veprimet penale "Mashttrimi me pasoja të rënda" të parashikuar nga neni 143/3 i K. Penal.

Në Prokurorinë e Tiranë më datën 21.10.2019 është regjistruar edhe procedimi penal Nr. 7981 për veprimet penale të parashikuar nga neni 143/3 i K. Penal që bënë fjalë për kallëzimin e shtetasit Dashnor Aliçka. Nga aktet rezulton se kallëzuesi pretendon se në vitin 1997 sëbashku me vëllain Hajredin Aliçka kanë blerë një sipërfaqe prej 1000 m² tokë arë të ndodhur në zonën e Yzberishtit, Tiranë e më pas bashkarisht kanë ndërtuar një objekt dy katësh, në vijim kallëzuesi Dashnor Aliçka është larguar në Greqi ku ka qëndruar si emigrant nga vitit 1997 dhe kur është kthyer në Qershor të vitit 2010 vëllai Hajredini i ka thënë se kundër dëshirës e nën presion i ka kishte shitur këtë pronë prej 1000 m² komshiut të tyre të quajtur Emror Kasaj i cili e kishte blerë sëbashku me shtetasin Luan Shehu (Maurizio Lombi) në shumën 5.000.000 lekë. Për këtë situatë Dashnori ka kontaktuar me shtetasin Luan Shehu (Maurizio Lombi) të cilit i ka shpjeguar se blerja që kishin bërë ishte e pa vlefshme pasi prona nuk ishte vetëm e Hajredinit por në bashkëpronësi. Luan Shehu (Maurizio Lombi) i kishte thënë se ai nuk donte një pronë që të kishte probleme dhe i ka shpjeguar se në këtë marrëdhënie kishte hyrë nëpërmjet Emror Kasaj dhe për blerjen e kësaj prone ai i kishte paguar Hajredinit me kështu shumën prej 104.000 euro dhe kështu e fundit prej 16.000 eurosh të cilin ja kishte dorëzuar Emrorit për t'ja dhënë Hajredinit. Kallëzuesi ka deklaruar se këtë shumë që përbën kështu e fundit në fakt Hajredini nuk e kishte marrë. Luan Shehu (Maurizio Lombi) i kishte thënë gjithashtu se ai ishte i gatshëm të merrte mbrapsht paratë që kishte dhënë dhe të hiqte dorë nga prona që kishte blerë.

Në kushtet kur nga organi i Prokurorisë po hetohet për rrethana dhe fakte të njëjta e për të njëjtët persona të dyshuar, ky procedim është bashkuar dhe po hetohet sëbashku me procedim penal nr. 524 datë 15.01.2019 në një procedim të vetëm.

Kallëzuesi ka shpjeguar se kur kishte biseduar më të vëllain ai i kishte pranuar që realisht kishte marrë shumën prej 104.000 eurosh prej shtetasit Luan Shehu (Maurizio Lombi). Kallëzuesi ka shpjeguar se në vijim të interesimit për të revokuar kontratën e shitjes kishte takuar edhe Emror Kasaj i cili i kishte thënë se nuk e kishte ditur faktin që ajo pronë ishte në bashkëpronësi dhe nëse Luani pranonte edhe ai ishte i gatshëm të hiqte dorë pasi ti ktheheshin paratë. Kallëzuesi ka deklaruar se në fakt të dy e kanë zvarritur këtë çështje deri kur në një takim që kish pasur përsëri me Emrorin për këtë çështje ai në këtë rast i kishte thënë se kërkonte një shumë prej 1.000.000 eurosh që të bënin revokimin e kontratës së shitjes.

Në këto kushte kallëzuesi ka deklaruar se i është drejtuar Gjykatës për të kërkuar pavlefshmërinë e kontratës së shitjes dhe sapo ka filluar gjyqin civil ai sëbashku me vëllain Hajredinin janë kallëzuar nga shtetasi Emror Kasaj për fallsifikim të dokumenteve. Ky proces ka përfunduar me pushimin e çështjes me vendim të formës së prerë, ndërsa gjykimi civil aktualisht ndodhet për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

I pyetur në lidhje me rrethana konkrete ku i mbështet pretendimet e tij, kallëzuesi ka deklaruar se ai mendon që Emror Kasaj ka ndikuar tek noterja për të mos pasqyruar saktësisht në aktin noterial pronën që shitej dhe konkretisht një objekt tre katësh me sipërfaqe 1300 m² në proces legalizimi i cili është ndërtuar bashkarisht nga ai dhe i vëllai i tij.

Gjithashtu kallëzuesi ka deklaruar se Emror Kasaj ka ushtruar ndikimin e tij për shkak të detyrës që kishte edhe në ZVRPP për marjen e kartelës së pasurisë me qëllim për të realizuar blerjen e pronës, kartelë e cila nuk pasqyronte realitetin sipas tij pasi në vitin 1999, shtetasi Hajredin Alicka më parë ja kishte shitur këtë pronë baxhanakut të tij Behar Abazaj i cili e kishte rregjistruar atë në emër të tij.

Kallëzuesi pretendon se Emror Kasaj në muajin Shtator të vitit 2010 kishte shkuar i shoqëruar edhe me persona të tjerë për të marrë forcërisht në posedim objektin. Ai ka cituar se sipas tij kjo shitje është bërë edhe në kundërshtim me ligjin i cili nuk lejon shitjen e tokës arë pa marrë më parë miratimin e të gjithë anëtarëve të familjes bujqësore dhe gjithashtu edhe shitja e objektit informal është bërë pa asnjë dokument pronësie.

Shtetasi Dashnor Alicka pretendon se i kallëzuari prej tij Emror Kasaj ka mashtruar duke deklaruar se kishte blerë sipërfaqen e tokës në shumën 5.000.000 lekë dhe se kishte paguar 250.000 euro për objektin informal që ndodhet mbi këtë pronë, dhe se për të realizuar këtë blerje kishte marrë edhe kredi bankare. Për të mbështetur deklaratimet e tij kallëzuesi Dashnor Alicka ka paraqitur në cilësinë e provës edhe një regjistrim video të rregjistruar sipas deklaratimeve të tij prej shtetasit Maurizio Lombi, për të cilat ka shpjeguar se janë transmetuar disa kohë më parë në emisionin investigativ STOP, ku rezulton sipas tij se i kallëzuari prej tij Emror Kasaj, në bisedë të lirë me Maurizion diskutojnë mbi rrethanat e faktit.

I pyetur në lidhje me mënyrën se si i ka siguruar këtë regjistrim, kallëzuesi ka deklaruar se regjistrimin ja kishte dërguar shtetasi Maurizio Lombi me qëllim që ti përdor si provë për kallëzimin penal. Kallëzuesi deklaroi se ai i ka kallëzuar të dy këta persona Emëror Kasaj dhe Maurizio Lombin pasi është ndjerë i mashtruar edhe nga Maurizio për faktin se ai mund të tja kishte bërë me dije edhe më parë këto fakte por ai e kishte gënjyer e mbajtur me shpresa me qëllim për të përfituar nga gjyqet civile dhe kur gjyqi është humbur prej Emërorit, Maurizio i ka kërkuar atij lekët. Kallëzuesi ka deklaruar se sipas tij i kallëzuari Emëror Kasaj ka bërë deklaratim të rremë edhe në formularët e deklaratimit të pasurisë ku ka deklaruar këtë pronë në vitin 2013 kur në fakt kjo shitje është bërë në vitin 2010. I pyetur në lidhje me kallëzime të tjera të mëparshme ndaj shtetasit Emëror Kasaj ai ka deklaruar se kishte paraqitur edhe më parë kallëzim në disa raste për të cilat organi i prokurorisë ka vendosur për mosfillimin e hetimeve.

Nepermjet procesverbalit të kqyrjes dhe marrjes së dokumentave date 23.10.2019 është administruar kallzimi i dates 21.06.2018 dhe Vendimi për Mosfillimin e procedimit penal date 26.06.2018 i prokurorit.

Eshtë administruar shkresa me nr.3017/1 Prot., date 04.05.2020 dërguar nga ASHK, drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, ku ka rezultuar se pasuria e ndodhur në ZK.3866, me nr.380/5, vol.9, fq.189, me sipërfaqe 1.000 m², e regjistruar në emër të shtetasve Emror Kasaj dhe Maurizio Ahmet Lombi. Kjo pasuri është blerë nga keta shtetas nepermjet aktit të shitblerjes me nr.696 rep dhe me nr.175 kol., date 25.03.2010 nga shtetasi Haredin Alicka dhe Zamira Alicka. Në dokumentacionin e dërguar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Rurale 2, nuk rezulton se kallzuesi të jetë bashkepronar me shtetasit Haredin dhe Zamira Alicka.

Kallzuesi Dashnor Alickaj ka vene ne dispozicion dy USB me regjistrime Audio-Vizive te cilat ia ka dhene shtetasi Maurizio Lombi. Nje pjese e ketyre regjistrimeve jane transmetuar nga emisioni investigativ "Stop" i transmetuar ne televizionin TV Klan, ne date 19.02.202019.

Ne funksion te hetimit te ketij procedimi penal eshte vendosur kryerja e nje akti ekspertimi Teknik mbi filmimet e vena ne dispozicion si dhe transkriptimi i bisedave qe gjenden ne kete filmim, me qellim evidentimin e faktit penal.

Nga pergjigja e ardhur me aktin e ekspertimit me nr. 122 date 27.11. 2020derguar nga Qendra per Ekspertime Kompjuterike Ligjore, ka rezultuar se :

1-Në memorien e dy pajisjeve "USB" me të njëjtat mbishkrime "TREQA, 4G" objekt ekspertimi, ku njëra ka emërtimin "DASHNOR", ndërsa tjetra ka emërtimin "USB Drive", u konstatua se janë ruajtur nëntë skedarë video-audio të formatit ".mp4" të cilat mbajnë përkatësisht emërtimet: "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4", "130.MP4", "131.MP4", "Stop++Prokurori+Emeror+Kasaj+dhe+mashtrimi+i+dy+paleve+me+pronën+300+mijë+euro!+(19+shkurt+2019).mp4" dhe "Stop-Prokurori+Emëror+Kasaj+dhe+mashtrimi+i+dy+palëve+me+pronën+300+mijë+euro.(19.02.2019).mp4".

-Nëntë skedarët video që janë ruajtur në memorien e pajisjes USB-1 dhe në memorien e pajisjes USB-2 objekt ekspertimi, janë skedarë identikë pasi vlerat hash MD5 dhe SHA1 (vlera unike për një skedar dixhital) e tyre është e njëjtë.

-Nga shikimi, dëgjimi, transkriptimi dhe analizimi i përmbajtjes së skedarëve me emërtimet: "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4", "130.MP4" dhe "131.MP4", u konstatua se ato paraqesin disa rregjistrime video-audio, përmbajtja e të cilave duket se ka vijueshmëri të pamjeve video dhe bisedave të zhvilluara.

-U konstatua se dy skedarët 8 dhe 9 me emërtimet: "Stop+-Prokurori+Emeror+Kasaj+dhe+mashtrimi+i+dy+paleve+me+pronën+300+mijë+euro!+(19+shkurt+2019).mp4", dhe "Stop-Prokurori+Emëror+Kasaj+dhe+mashtrimi+i+dy+palëve+me+pronën+300+mijë+euro.(19.02.2019).mp4", janë krijuar si rezultat i montimit (montazhit) me programe të posaçme të disa sekuencave të ndryshme me pamje filmike që i përkasin emisionit investigativ me logot "STOP" dhe "tvklan.al", si dhe disa sekuencave filmike dhe audio-transkriptime të shkëputura nga përmbajtja e skedarëve me emërtimet "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4" dhe "130.MP4", të cilat janë alternuar duke krijuar një skedar video të vetëm. Këto dy skedar mund të jenë shkarkuar nëpërmjet shfletuesit "Google" me datë 20.02.2019.

-Në lidhje me këto skedarë video-audio, nuk mund të përcaktohet nëse ka apo jo, "ndërrhyrje mekanike në rregjistrim, ndërprerje, mbivendosje zërash e pamjesh, apo ndërrhyrje të natyrave të tjera", pasi nuk disponojmë programe dhe pajisje të posaçme për përcaktimin e këtyre proceseve.

2-Skedarët video të ruajtur në dy pajisjet "USB" objekt ekspertimi, me emërtimet "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4", "130.MP4" dhe

"131.MP4", janë në formatin video ".MP4", ato nuk ruajnë në metadatat e tyre emrin apo modelin e pajisjes videorregjistruese me të cilën janë realizuar. Nga analizimi i metadatave të tyre nuk u arrit të përcaktohet pajisja me të cilin janë rregjistruar këto skedarë video.

-Analizimi më i detajuar i metadatave të skedarëve video-audio me emërtimet "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4", "130.MP4" dhe "131.MP4" të vënë në dispozicion në dy USB-të objekt ekspertimi, dhe përcaktimi nëse kanë pësuar ndryshime apo jo pas rregjistrimit të tyre, mund të realizohet vetëm nëse na vihet në dispozicion pajisja videorregjistruese origjinale, në memorien e së cilës ruhen rregjistrimet video-audio të realizuara prej saj.

-Dy skedarët e tjerë me mërtimet: "Stop+-Prokurori+Emeror+Kasaj+dhe+mashtrimi+i+dy+paleve+me+pronën+300+mijë+euro!+(19+shkurt+2019).mp4", dhe "Stop-Prokurori+Emëror +Kasaj +dhe+mashtrimi+ i+dy+palëve+me+pronën+300+mijë+euro.(19.02.2019).mp4", janë gjithashtu në formatin video ".mp4", ato nuk ruajnë në metadatat e tyre emrin apo versionin e programit me të cilën janë realizuar (montuar). Nga analizimi i metadatave të tyre nuk u arrit të përcaktohet programi me të cilin janë realizuar (montuar).

3-Përmbajtja e plotë e pamjeve dhe komunikimeve që na paraqiten (dëgjohen) në skedarët objekt ekspertimi, me emërtimet "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4", "130.MP4" dhe "131.MP4", është traskriptuar dhe pasqyruar për çdo skedar veçmas në pjesën ekzaminative të këtij akti ekspertimi. Për më shumë detaje, këto skedarë mund të shihen e dëgjohen nga ana Juaj.

-Gjithashtu sekuencat e bisedave që janë shkëputur nga skedarët me emërtimet "125.MP4", "126.MP4", "127.MP4", "128.MP4", "129.MP4" dhe "130.MP4", e më pas montuar në dy skedarët me emërtimet "Stop+-Prokurori+Emeror+Kasaj+dhe+mashtrimi+i+dy+paleve+me+pronën+300+mijë+euro!+(19+shkurt+2019).mp4" dhe "Stop-Prokurori+Emëror+Kasaj+dhe+mashtrimi +i+dy+palëve+me+pronën+300+mijë+euro.(19.02.2019).mp4", janë traskriptuar dhe pasqyruar sipas kronologjisë kohore, për çdo skedar veçmas në pjesën ekzaminative të këtij akti ekspertimi. Për më shumë detaje, këto dy skedarë mund të shihen e dëgjohen nga ana Juaj.

Duke u bazuar në aktin e ekspertimit të mesiperm dhe në konkluzionet e tij, organi I akuzës ka arritur në përfundimin se në kushtet kur nuk është vene në dispozicion pajisja videorregjistruese origjinale nuk mund te percaktohet nese ka patur apo jo nderhyrje ne rregjistrimin e depozituar nga kallzuesi Dashnor Alicka. Për këtë arsye pamjet audio vizive nuk mund te konsiderohen si prove materiale nese nuk eshte administruar mjeti i marrjes se proves materiale.

Në materialin kallezues vlen të theksohet se pretendimet e kallzuesit Dashnor Alicka mbi pavlefshmerine e kontratës së shitblerjes lidhur midis palës shitesë Hajredin dhe Zamira Alicka dhe palës blerëse Emror Kasaj dhe Maurizio Lombi, jane nje mardhenie juridiko-civile, pasi ky shtetas pretendon se ka qene bashkëpronar me vëllain e tij Hajredin Alicka

dhe ky i fundit nuk ka pasur të drejte të shesë pasurine e cila është në bashkëpronësi të tyre. Për zgjidhjen e kësaj mosmarrveshje është kompetente Gjykata e Shkalles së Parë Tirane.

Shtetasi Dashnor Alicka i është drejtuar me padi gjykates për pavlefshmeri të kontatës së shitjes dhe padia është rrëzuar në të dy shkallët e gjyqimit dhe çështja është për gjykim në gjykatën e lartë. Shtetasit Emrror Kasaj dhe Maurizio Lombi nga aktet e administruara nuk rezultojnë të kenë konsumuar elementet e veprës penale "Mashttrim" të pretenduar nga kallzuesi Dashnor Alicka, pasi ndodhemi para një marrëdhënie juridiko civile e cila ka qenë objekt gjykimi në gjykatën civile. Sic e cituam me sipër marrëdhëniet midis shtetasve Emrror Kasaj, Maurizio Lombi dhe Hajredin Alicka për blerjen e pronës është konkretizuar me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes për pasurisë prej 1.000 m².

Nga aktet e administruara në dosjen hetimore nuk rezultojnë se shtetasi Emrror Kasaj nëpërmjet detyrës që ka ushtruar në vitin 2010 e në vijim, të ketë ndikuar ndaj noterës për përpilimin e deklaratës noteriale të shitblerjes së pronës. Kallzuesi pretendon se ndaj vëllait të tij Hajredin Alicka i është ushtruar presion me qëllim nënshkrimin e kontratës së shitblerjes në vitin 2010. Shtetasi Hajredin Alicka nga ana e tij deri me sot, nuk e ka pretenduar kurrë një fakt të tillë, edhe pse kanë kaluar me shumë se 10 vite nga data e lidhjes së kontratës së shitblerjes.

Për sa më sipër organi i akuzës bazuar në provat e ndodhura në dosjen hetimore si dhe bazuar në nenin 328/1/b, 329/a ka kërkuar pushimin e hetimeve për veprën penale të parashikuar nga neni 143/3 të Kodit Penal.

➤ **I. Vlerësimi i Gjykatës në lidhje me dërgimin e çështjes në gjyq.**

Në çështjen objekt gjykimi, prokuroria e akuzon të pandehurin **Maurizio Lombi (Luan Shehu)** për veprën penale "Mashtrimi", të parashikuar nga neni 143/3 të Kodit Penal.

Gjykata vlerëson se mbi bazën e provave të administruara rezultojnë se ka prova të mjaftueshme që mbështesin akuzën. Gjithashtu, Gjykata çmon se cilësimi juridik i bërë faktit penal nga prokuroria është i drejtë.

I.1. Lidhur me kërkesën për gjykim të shkurtuar.

Në zbatim të nenit 332/c pika 3 të K.Pr.Penale nën titullin "**Zhvillimi i seancës**" i pandehuri mund të paraqesi përpara gjyqtarit të seancës paraprake kërkesë për gjykim të shkurtuar, ndërsa në nenin 332/dh pika 1 gërma "c" të K.Pr.Penale nën titullin "**Vendimi i gjyqtarit të seancës paraprake**", ku thuhet shprehimisht: "1. Pasi dëgjon diskutimet e palëve, gjykata vendos:.....; c) dërgimin e çështjes në gjykatën kompetente kur i pandehuri ka kërkuar gjykimin e shkurtuar, pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve, sipas parashikimeve të nenit 332/c të këtij Kodi".

Në nenin 403 të K.Pr.Penale nën titullin "**Kërkesa për gjykimin e shkurtuar**" parashikohet shprehimisht se: "1. **Kërkesa për gjykimin e shkurtuar paraqitet** nga i pandehuri ose mbrojtësi i tij me autorizim të posaçëm **në seancën paraprake** ose në seancë gjyqësore kur procedohet sipas nenit 400 dhe paragrafit 3, të nenit 406/ç, të këtij

Kodi, me pasojë mospranimi. 2.Nuk lejohet kërkesa për gjykim të shkurtuar për veprat penale për të cilat parashikohet dënim me burgim të përjetshëm.”,

Nga përmbajtja e këtyre dispozitave del se nuk është gjyqtari i seancës paraprake që vendos miratimin e kërkesës për gjykim të shkurtuar por ai pasi kryen verifikimin mbi gjendjen e akteve ja kalon çështjen gjyqtarit të themelit, i cili caktohet me short.

Lidhur me kërkimin e avokates **Olta Myftaraj** për mospranimin e kërkesës së prokurorit për dërgimin e çështjes në gjyq dhe kthimin e çështje ose pushimin e çështjes në ngarkim të të pandehurit **Maurizio Lombi (Luan Shehu)**,Gjykata çmon se një vlerësim i tillë është atribut i gjykatës së themelit e cila vlerëson dhe çmon provat në unitet me njëra-tjerën. Në rastin objekt shqyrtimi,Gjykata çmon se kërkesa e paraqitur nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë për kalimin në gjykim të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit **Maurizio Lombi (Luan Shehu)**,i plotëson të gjitha elementët formale e substanciale të kërkuar nga ligji procedural penal për t’iu nënshtruar gjykimit të themelit, sipas nenit 332/dh/1/a të K. Pr. Penale.**Avokatia Olta Myftarajtë paraqiti kërkesën për gjykim të shkurtuar në rast se gjykata çmonte se kjo çështje duhet të dërgohet për gjykim.**

Lidhur me kërkimin e paraqitur nga organi i akuzës për pranimin e padisë civile ngritur nga viktima **Emror Kasaj** në procesin penal ,Gjykata cmon se një vlerësim i tillë është atribut i gjykatës së themelit .

I.II.Lidhur me përmbajtjen e fashikullit të gjykimit.

Në nenin 332/ë të K.Pr.Penale nën titullin **“Fashikulli i gjykimit”** parashikohet shprehimisht se: **“1. Kur gjykata vendos dërgimin e çështjes në gjyq, pasi dëgjon palët, përcakton aktet që duhet të përmbajë fashikulli i gjykimit:**

Në rastin konkret, Gjykata çmon se fashikulli i gjykimit në çështjen penale në ngarkim të të pandehurit **Maurizio Lombi (Luan Shehu)** dhe që do t’i dërgohen gjykatës së themelit, përmban aktet si më poshtë vijon:

1. Aktet e hetimeve paraprake.
- 2.Aktet e kryera gjatë seancës paraprake.

➤ II.Vlerësimi i Gjykatës ne lidhje me pushimin e çështjes .

II.I. Konisderata të përgjithshme.

Neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: “Prokuroria ushtron ndjekjen penale si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit”. Nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Përcaktimi sa më i saktë i detyrave që ka secili aktor në procesin penal është një nga kërkesat kryesore që duhet të plotësojë kuadri kushtetues dhe ligjor në një shtet të së drejtës. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke

garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror. Ky detyrim i shtetit rrjedh nga fakti se ai është garanti i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kriterëve të përcaktuara qartë dhe në mënyrë sa më të detajuar.

Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm që ndihmon në dhënien e drejtësisë penale. Ky organ i specializuar ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Ligji procedural penal parashikon të gjitha fazat e hetimit paraprak që duhet të kryhen nga prokuroria, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale. Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari. Akuza është procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

Gjithashtu, në nenin 291 dhe 329 të K.Pr.Penale, është parashikuar e drejta e kontrollit gjyqësor ndaj vendimit të prokurorit për **mosfillimin dhe pushimin e procedimit penal gjatë fazës së hetimeve paraprake**. Ky kontroll ushtrohet në funksion të parimit të ligjshmërisë së procedimit penal dhe të garantimit të të drejtave të palëve të përfshira në të. Sipas jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, kjo e drejtë për të kundërshtuar veprimet e prokurorit në rrugë gjyqësore, pra për t'iu drejtuar një autoriteti të pavarur dhe paanshëm, është në përputhje edhe me standardet e vendosura nga neni 42 i Kushtetutës. Në parim, ligjvënësi ia ka nënshtruar të gjitha veprimet hetimore paraprake kontrollit gjyqësor. **Praktika njeh dy mënyra për ushtrimin e këtij kontrolli: ose nëpërmjet gjykatës së themelit ose nëpërmjet gjyqtarit hetues**, i cili, në legjislacionet e disa vendeve, është organi kompetent për të kontrolluar të gjitha veprimet hetimore paraprake para se çështja t'i kalojë për gjykim gjykatës kompetente. Në fund është gjykata që ka të drejtë të shprehet për të gjitha veprimet hetimore përfshirë edhe vendimin e pushimit të çështjes. Gjykata gjatë shqyrtimit të këtij vendimi duhet të konstatojë, nëse prokurori e ka pushuar çështjen në zbatim të ligjit dhe mbështetur në prova dhe argumente të mjaftueshme apo jo, ose nëse prokurori realisht i ka bërë të gjitha përpjekjet për të zbuluar faktin, pavarësisht përfundimit ku ka arritur.

Në K.Pr.Penale janë parashikuar në mënyrë shteruese kompetencat e gjyqtarit të seancës paraprake, të cilat janë: 1) shqyrtimi i ankimit ndaj vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes për kundërvajtjet penale mbi ankimin e të pandehurit, viktimës ose trashëgimtarëve e saj dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi, brenda pesëmbëdhjetë ditëve nga marrja e akteve. Në rastet kur

prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, por për njërin ose disa nga akuzat ka vendosur pushimin, ankimi ndaj vendimit të pushimit shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë rast ankimi shqyrtohet në prani të palëve, prokurorit, të pandehurit dhe me pjesëmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit të tij dhe me praninë e viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim, në një seancë me dyer të mbyllura.

Në përfundim gjyqtari i seancës paraprake vendos: a) lënien në fuqi të vendimit të pushimit, kur çmon se janë kushtet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi; b) kthimin e akteve prokurorit dhe vazhdimin e hetimeve, kur çmon se ato janë të paplota, duke përcaktuar drejtimit e thellimit të tyre dhe, kur është rasti, edhe veprimet që duhet të kryhen, si dhe cakton afatin brenda të cilit hetimet duhet të përfundojnë; c) kthimin e akteve prokurorit, duke e urdhëruar që të formulojë akuzë dhe të paraqesë kërkesë për gjykimin e çështjes, kur çmon se hetimet janë të plota dhe rezulton se ka prova të mjaftueshme për të mbështetur akuzën në gjyq. Kur nga aktet rezultojnë të dhëna për vepra penale të tjera, që ndiqen kryesisht ose në ngarkim të personave të tjerë, gjykata mund të kërkojë që të kryhen hetime, edhe në rastet kur vendos sipas shkronjës "c", të paragrafit 3, të nenit 329 të K.Pr.Penale.

Në rastet e kthimit të akteve prokurorisë, gjyqtari i seancës paraprake i vendimin ja njofton edhe drejtuesit të prokurorisë; 2) shqyrton kërkesën e prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes penale kur procedohet për krime dhe kur është një nga rastet e parashikuara nga paragrafi i parë, i nenit 328 të K.Pr.Penale. Kërkesa shqyrtohet nga gjyqtari i seancës paraprake në seancë me dyer të mbyllura, në prani të palëve. Kur pala nuk paraqitet, ndonëse është njoftuar rregullisht, ose refuzon të paraqitet, pa parashtruar shkaqe të arsyeshme, gjykimi zhvillohet pa praninë e saj. Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq. Në këtë rast ankimi shqyrtohet në prani të palëve, prokurorit, të pandehurit dhe me pjesëmarrjen e domosdoshme të mbrojtësit të tij dhe me praninë e viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, në një seancë me dyer të mbyllura. Në përfundim gjyqtari i seancës paraprake vendos njëllë si rastet e cituara më lartë kur shqyrton ankimin kundër vendimit të prokurorit për pushimin e akuzës ose të çështjes për kundërvajtjet penale; 3) shqyrtimin e kërkesës për revokimin e vendimit të pushimit të akuzës ose çështjes me kërkesë të prokurorit, të viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur dalin ose zbulohen të dhëna apo prova të reja, të cilat tregojnë se vendimi nuk është i bazuar. Kërkesa shqyrtohet në dhomë këshillimi. Kur vendos pranimin e kërkesës, gjykata revokon vendimin e pushimit dhe i kthen aktet prokurorit, i cili rifillon hetimet; 4) shqyrtimin e ankimit të viktimës ose personit që ka bërë kallëzim për vendimit e prokurorit për pezullimin e hetimeve. Ankimi shqyrtohet në dhomë këshillimi brenda 30 ditëve. Kundër vendimit nuk lejohet ankim. Kur ankimi pranohet, gjykata vendos rifillimin e hetimeve.

Sa më sipër u arsyetua, Gjykata çmon se përpara se të merret vendimi për pushimin e çështjes në gjyq, gjyqtari i seancës paraprake ka detyrimin të analizojë kryesisht nëse kjo

kërkesë është e bazuar në prova dhe ligj si nga pikëpamja e mjaftueshmërisë së provave, ashtu edhe nga pikëpamja e përdorshmërisë së tyre dhe vlefshmërisë së akteve procedurale (absolute kryesisht dhe relative me kërkesë të palëve). Gjithashtu, gjykata duhet të analizojë ekzistencën e faktit penal dhe lidhjen e të pandehurit me këtë fakt penal, si dhe faktin nëse cilësimi juridik i bërë nga prokuroria faktit penal është i drejtë.

Duke u rikthyer në çështjen objekt gjykimi, prokuroria kërkon pushimin e çështjes penale për veprën penale “**Mashtrimi**” të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

Sipas nenit 328 të K.Pr.Penale sanksionohet se: Pushimi i akuzës ose çështjes (Shtuar pika 1 me ligjin nr.8460, datë 11.2.1999) (Ndryshuar me ligjin nr. 35/2017).

1.Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për kundërvajtje penale, prokurori vendos pushimin e akuzës ose çështjes kur:

a) del qartë se fakti nuk ekziston;

b) fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale;

c) i dëmtuari nuk ka bërë ankim ose heq dorë nga ankimi në rastet që procedimi fillon me kërkesën e tij;

ç) personi nuk mund të merret si i pandehur ose nuk mund të dënohet;

d) ekziston një shkak që e shuan veprën penale ose për të cilin ndjekja penale nuk duhej të fillohej ose nuk duhet të vazhdojë;

dh) del se i pandehuri nuk e ka kryer veprën ose nuk provohet që e ka kryer ai;

e) me vendim të formës së prerë i pandehuri është gjykuar për të njëjtën vepër penale;

ë) i pandehuri vdes;

f) në rastet e tjera të parashikuara me ligj.

2. Prokurori, brenda 5 ditëve nga marrja e vendimit të pushimit, njofton të pandehurin, mbrojtësin e tij, viktimën ose trashëgimtarët e saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personin që ka bërë kallëzim ose ankim, duke u bërë të ditur të drejtën për t’u njohur me aktet, për të marrë kopje të tyre dhe për të paraqitur ankim në gjykatë.

Neni 329/a të K.Pr.Penale sanksionohet se: Kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes (Shtuar me ligjin Nr. 35/2017).

1.Në përfundim të hetimeve paraprake, kur procedohet për krime dhe kur është njëri nga rastet e parashikuara nga paragrafi 1, i nenit 328, të këtij Kodi, prokurori i kërkon gjyqtarit të seancës paraprake pushimin e akuzës ose çështjes.

2.Në rastet kur prokurori ka paraqitur kërkesë për dërgimin e çështjes në gjyq, kërkesa për pushimin e akuzës ose çështjes shqyrtohet bashkërisht me kërkesën për dërgimin e çështjes në gjyq.

3.Kërkesës së prokurorit i bashkëlidhen aktet dhe provat që përmban fashikulli i hetimeve, duke përfshirë edhe aktet e kryera para gjyqtarit të hetimeve paraprake, si dhe provat materiale, përveç rastit kur ato ruhen në vend tjetër.

4. Kërkesa i njoftohet të pandehurit, mbrojtësit të tij, viktimës ose trashëgimtarëve të saj kur identiteti dhe vendbanimi i tyre rezultojnë nga aktet e procedimit, si dhe personit që ka bërë kallëzim ose ankim. Ata kanë të drejtë të njihen me aktet dhe provat, si dhe të marrin kopje të tyre.

Gjykata cmon se kërkesa e organit të akuzes është e drejte dhe duhet pranuar referuar nenit 328/1/b dhe 329/a të K.Pr.Penal. Organi i akuzës ka kryer hetime të plota e të gjithanshme për procedimin penal objekte gjykimi. Në analizë të provave gjykata arrin në konkluzionin se nuk ka elemente të veprës penale **“Mashtrimi”** të parashikuar nga neni 143 i K.Penal apo të ndonjë vepre penale tjetër të parashikuar nga K.Penal .

Për sa më lart ,Gjykata, duke i çmuar provat, e paraqitura e të administruara në gjykim, në unitet me njëra-tjetrën, bazuar në nenin 152 të K.Pr.Penale, i cili përcakton mënyrën e çmuarjes së provave, vlerësimin e fuqisë provuese dhe vërtetësisë së tyre në bazë të përmbajtjes së secilës dhe bindjes së brendshme të gjykatës,arrin në konkluzionin se jemi përpara rasteve të parashikuara nga neni 328/1/b i Kodit të Procedurës Penale.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, bazuar në nenet 328 ,329 dhe 331 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ne nenin 143 të Kodit Penal

VENDOSI:

1.Pranimin e kërkesës së prokurorit dhe dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me **Nr.524 viti 2019**,në ngarkim të të pandehurit **Maurizio Lombi (Luan Shehu)**,i cili akuzohet për veprën penale **“Mashtrimi”** të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal .

-Dërgimin e çështjes për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, Dhoma Penale.

-Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankim.

2.Pranimin e kërkesës së prokurorit dhe pushimin e ceshtjes penale që i përket procedimit penal me **Nr.524 viti 2019**, për veprën penale **“Mashtrimi”**,të parashikuar nga neni 143/3 i Kodit Penal.

-Shpenzimet gjyqësore sic janë bërë.

-Kundër vendimit prokurori dhe kallëzuesi nuk mund të bëjnë ankim në Gjykatën e Apelit Tirane.

U shpall sot në Tiranë, më datë 15.02.2021 .

S e k r e t a r e
ORNELA BALLA

Gjyqtar
ARTAN GJERMËNI

Shpenzime gjyqësore:
Njoftime 4 copë x 150.00 Lekë - 700.00 Lekë
Shpenzime procedurale të Prokurorisë 53 000.00 Lekë